



VENDIM

Nr.20 Datë 11.02.2013

PËR

FILLIMIN E PROCEDURAVE TE SHQYRTIMIT TE APLIKIMIT PER MODIFIKIMIN E LICENCES ME Nr.10 ,SERIA PV03P PER PRODHIMIN E ENERGJISE ELEKTRIKE NGA HEC "BICAJ" ME FUQI 100 KW TE SHOQERISE "EN.KU" SH.P.K .

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma "ll", 9 dhe 39 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa "d", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 21 datë 18.03.2009, dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të dates 11.02.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "EN.KU" sh.p.k për fillimin e modifikimit te licences per "Prodhimin e Energjise Elektrik" nga Hec "BICAJ" .

Konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "EN.KU" sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat "a", "b", "c", "d"**
Pershkrimi i pergjithshem i centralit.

Ky dokumentacion eshte dhene i sakte dhe i plote.

- **Neni 7, pika 2, gërmat "a", "b", "c", "d"**
Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e pergjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion eshte paraqitur ne menyre korrekte.

- **Neni 7 pika 3, gërmat “a“, “b“, “c“**
Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion eshte dhene i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin te aplikimit per modifikimin te licences me Nr.10 ,Seria PV03P per Prodhimin e Energjise Elektrike nga Hec “BICAJ” me fuqi 100 KW te Shoqerise “EN.KU” sh.p.k.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI